



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.699/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit H.L. BI me emër tregtar Bujtina Buna me seli në Pejë, i përfaqësuar me autorizim nga shoqëria e avokatëve Kërveshi&Partners shpk, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.95/24 të datës 23.12.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.95/2024 i datës 23.12.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, është Aprovuar si e bazuar kërkesa e paditësit H.L. BI me emër tregtar Bujtina Buna me seli në Pejë, me numër identifikues 811995622, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe ka Shtyrë ekzekutimin e vendimit nr.07/04/187 datës 09.11.2023, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përkritazi me kërkesëpadinë.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e të paditurës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që Dhomat e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta Refuzoj shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, nr.07/4/187 i datës 09.11.2023.

Në përgjigjen në ankesë, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pathemeltë ankesën e të paditurës, dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.95/2024 i datës 23.12.2023.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së të paditurit, konstaton se Dhomat e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.07/4/187 datës 09.11.2023 i nxjerr nga e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par.2 të LKA-së, për të aprovuar të njëjtën, pasi që paditësi kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ka paraqitur argumente bindëse të bazuara në prova se i njëjti investimet në biznesin individual “Bujtina Buna” i ka realizuar pas aprovimit të përkrahjes financiare nga e paditura për përkrahje publike dhe mbështetje nga programi i zhvillimit rural 2022. Paditësi për realizimin e investimeve ka marrë kredi të cilën e kthen në këste mujore sipas marrëveshjes se kredisë, për të cilën ka bashkangjitur planin e pagesës së kredisë dhe pasqyrat financiare.

Prandaj gjykata vlerëson se ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar me të cilin shfuqizohet vendimi për paradhënie dt.23.12.2022 dhe obligohet paditësi për rikthimin e mjeteve financiare nga përkrahja publike në vlerë prej 30,000.00€ paditësit i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej, do të vështirësoje gjendjen financiare të paditësit. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe nuk përbën dëm të madh për të paditurën.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të Dhomës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do të sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do të sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditurit në ankesë, ndaj aktvendimit të Dhomës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu refuzuar propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i

kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nuk i pranoi si të bazuara pretendimet në ankesë se dhoma e shkallës së parë nuk ka arritur ta faktoj besueshmërinë e propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit për dëmin e pretenduar, se shtyrja e ekzekutimit të vendimit është në kundërshtim me interesin publik. Kolegji vlerësoi, se pretendimet ankimore nuk ndikojnë në ndryshimin e një gjendje tjetër faktike që e ka konstatuar Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për çështje administrative i Gjykatës Komerciale.

Pretendimet ankimore të palës së paditur, të cekura si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga Dhoma e shkallës së parë, Kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave kontestimore apo të LKA-së, neni 22 paragrafi 2, siç pretendon i padituri në ankesë.

Propozuesi në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurit, para gjykatës ka arsyetuar me dëshmi të besueshme dhe të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi, ekzekutimi i vendimit kontestues, do t'ia vështirësonte ushtrimin e aktivitetit afarist si biznes individual, dhe në anën tjetër do ti vështirësohej kryerja e obligimeve kontraktuale për kthimin e kredisë.

Prandaj edhe Dhoma e shkallës së dytë, duke marrë parasysh vendimet e të paditurës, respektivisht vendimin për kthimin e mjeteve financiare nga përkrahja publike datës 23.11.2023, dhe implementimin e projektit sipas planit të biznesit ku paditësi është përzgjedhur si përfitues i grantit sipas programit për zhvillimin rural 2022, pastaj raportet e kontrollit nga zyrtarët e paditurit sa i plotësimit të kriterëve nga paditësi në renovimin e bujtinës sipas planit të biznesit, provave materiale të paraqitura nga paditësi si: pasqyrat bankare, marrëveshja e kredisë, si biznes individual, janë prova të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësit do ti vështirësohej gjendja financiare në zhvillimin e rregullt të aktivitetit afarist, do ti shkaktonte vështirësi në pagesat e kredisë, prandaj Kolegji vlerësoi se shtyrja e ekzekutimit të vendimit është i domosdoshëm dhe se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparueshëm, e që shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, i vlerësoi të pabazuara pretendimet ankimore të paditurës, se aktvendimi i atakuar i sjell dëm të paditurës për shkak të mbledhjes së borxhit të dhënë në formë paradhënie. Kolegji vlerësoi se nuk kemi të bëjmë me ndonjë veprim konkret që do të dëmtonte apo rrezikonte interesin publik, në raport me mos mbledhjen e borxhit ndaj një biznesi individual i cili deri në marrjen e vendimeve kontestuese të paditurës, është përkrahur në Projektin e Zhvillimit Rural 2022.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata e Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të propozimit të paditësit-propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.07/4/187 datës 09.11.2023 i nxjerr nga e paditura Ministria e

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe se nuk është cënuar ligji në dëm të ankuesit. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar i Dhomave të Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.699/24 datë 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit
Krenar Berisha